

## **Parimet Bazë mbi Pavarësinë e Gjyqësorit**

**Miratuar nga Kongresi i Shtatë i Kombeve të Bashkuara mbi Parandalimin e Krimit dhe Trajtimin e kundërvajtësve mbajtur në Milano me 26 Gusht deri më 6 Shtator 1985 dhe e miratuar nga rezolutat e Asamblesë së Përgjithshme 40/32 29 Nëntor 1985 dhe 40/146 13 Dhjetor 1985**

Përderisa në Kartën e Kombeve të Bashkuara popujt e botës afirmojnë, mes tjerash, vendosmërinë e tyre për të krijuar kushte, në bazë të të cilave drejtësia mund të mbahet për të arritur bashkëpunimin ndërkombëtar në promovimin dhe inkurajimin e respektimit të drejtave dhe lirive themelore të njeriut pa asnjë diskriminim

Përderisa Deklarata e përgjithshme e të Drejtave të Njeriut në veçanti ruan parimet e barazisë përpara ligjit, supozimit të pafajësisë dhe të drejtës të një gjykimi të drejte dhe publik nga një gjykatë kompetente e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

Përderisa Konventat Ndërkombëtare mbi të drejtat Ekonomike Kulturore dhe Sociale si dhe të Drejtat Civile dhe Politike bashkë, garantojnë ushtrimin e këtyre të drejtave, dhe veq kësaj Konventa mbi të drejtat Civile dhe Politike më tutje garanton të drejtën për tu gjykuar pa asnjë vonesë të paarsyeshme.

Përderisa herë pas here ende ekziston një mospërputhje në mes të vizionit që themelon ato parime dhe situatës aktuale.

Përderisa organizimi dhe administrimi i gjyqësorit në çdo shtet duhet të inspirohet nga ato parime, dhe duhet të bëhen përpjekje që ato plotësisht të bëhen realitet.

Përderisa rregullat mbi ushtrimin e funksionit gjyqësor duhet t'ju mundësojnë gjyqtarëve që të veprojnë në pajtim me ato parime.

Përderisa gjyqtarët janë të ngarkuar me vendimin përfundimtar për jetën, liritë, të drejtat, detyrat dhe pronën e qytetarëve.

Përderisa Kongresi i Gjashtë i Kombeve të Bashkuara mbi Parandalimin e Krimit dhe Trajtimin e të pandehurve, nga rezoluta e tij e 16, i bëri thirrje Komisionit mbi Parandalimin dhe Kontrollimin e Krimit që në mesin e prioriteteve të tij të përfshijë përgatitjen e udhëzimeve lidhur me pavarësimin dhe përzgjedhjen e gjyqtarëve, trajnime profesionale dhe statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Duke pas parasysh se në radhë të parë duhet t'i ipet vëmendje rolit të gjyqtarëve lidhur me sistemin e drejtësisë dhe rëndësisë për zgjedhjen, trajnimin dhe sjelljen e tyre,

Parimet themelore në vijim, të formuluar për të ndihmuar shtetet anëtare në detyrat e tyre për të siguruar dhe promovuar pavarësinë e gjyqësorit duhet të merren parasysh dhe të respektohen nga Qeveritë brenda kornizës dhe praktikës së legjislacionit të tyre kombëtar dhe të vihen në vëmendjen e gjyqtarëve, avokatëve, anëtarëve të ekzekutivit dhe të organit ligjvënës dhe publikut në përgjithësi. Parimet janë formuluar kryesisht duke pasur në mendje gjyqtarët profesional por ato zbatohen njëjtë sipas rastit, për gjyqtarët porot ku ata janë.

## **Pavarësia e gjyqësorit**

1. Pavarësia e gjyqësorit duhet të garantohet nga Shteti dhe të ruhet me Kushtetutën apo ligjin e shtetit. Është detyrë e të gjithë qeveritarëve dhe institucioneve të tjera që të respektojnë dhe vëzhgojnë pavarësinë e gjyqësorit.
2. Gjyqësori duhet të vendosë për çështjet para tyre paanësisht, duke u bazuar në fakte dhe në pajtim me ligjin, pa asnjë kufizim, ndikim të padrejtë, nxitje, presion, kërcënim apo ndërhyrje, direkte apo indirekte, nga ndonjë drejtim apo për çfarëdo arsye.
3. Gjyqësori duhet të ketë juridiksion mbi të gjitha çështjet të natyrës juridike dhe duhet të ketë autoritet ekskluziv për të vendosur nëse një çështje e dorëzuar për vendim të tij është brenda kompetencave të tij siç e parasheh ligji.
4. Nuk duhet të ketë asnjë ndërhyrje të papërshtatshme apo të pajustificuar në procesin gjyqësor, e as vendimet gjyqësore nuk duhet t'i nënshtrohen kurrfarë rishqyrtimit. Ky parim është pa paragjykim për rishikim gjyqësor apo për zbutjen apo uljen e dënimit nga organet kompetente të dënimit e dhëna nga gjyqësori në pajtim me ligjin.
5. Secili ka të drejtë të gjykohet nga gjykatat e rregullta apo tribunalet duke përdorur procedurat të themeluara me ligj. Tribunalet që nuk përdorin procedurat siç duhet procedurat e procesit ligjor nuk duhet të krijohen për të zhvendosur juridiksionin që ju përket gjykatave të rregullta apo tribunaleve gjyqësore.
6. Parimi për pavarësimin e gjyqësorit i jep të drejtë dhe kërkon që gjyqësori të siguron që se procedurat gjyqësore janë përcjellë në mënyrë të drejtë si dhe janë respektuar të drejtat e palëve.
7. Është detyrë e secilit Anëtar të Vendit që të sigurojë burime adekuate që ti mundësojë gjyqësorit që në mënyrë të duhur ti kryejë funksionet e tij.

## **Liria e Shprehjes dhe Asociacionit**

8. Në pajtim me Deklaratën e Përgjithshme mbi të Drejtat e Njeriut, anëtarët e gjyqësorit kanë të drejtën si të gjithë qytetarët e tjerë për lirinë e shprehjes, besimit, shoqërimin dhe tubimin; mirëpo me kusht që në ushtrimin e atyre të drejtave, gjyqtarët gjithmonë duhet ti përmbahen vetvetes në atë mënyrë që të ruajnë dinjitetin e zyrës së tyre si dhe paanësinë dhe pavarësinë e gjyqësorit.
9. Gjyqtarët duhet të jenë të lirë të formojnë dhe ti bashkohen asociacionit të gjyqtarëve apo organizatave të tjera për ti prezantuar interesat e tyre, për të promovuar trajnimin e tyre profesional si dhe të ruajnë pavarësinë gjyqësore të tyre.

## **Kualifikimet, përzgjedhjet dhe trajnimet**

10. Personat e zgjedhur për zyrën gjyqësore duhet të jenë persona me integritet dhe aftësi të trajnuar në mënyrë të duhur apo të kualifikuar me ligj. çdo metodë e përzgjedhjes së gjyqtarit duhet të përjashtojë çfarëdo motivi të përzgjedhjes për arsye të parregullta. Gjatë përzgjedhjes së gjyqtarëve nuk duhet të ketë diskriminime racore, ngjyrës, seksit, religjionit, politike apo mendime të tjera, origjinës kombëtare apo sociale, pronës, lindjes apo statusit,

përveç kushtit që kandidati për zyrën gjyqësore duhet të jetë shtetas i vendit në fjalë, kusht i cili nuk duhet të konsiderohet si diskriminim.

### **Kushtet e shërbimit dhe qëndrimit**

11. Mandati i gjyqtarëve , pavarësia e tyre, siguria, pagesa adekuate, kushtet e shërbimeve, pensionet si dhe mosha e pensionimit duhet që në mënyrë të duhur të sigurohen me ligj

12. Gjyqtaret, të emëruar ose të zgjedhur, duhet ta kenë të garantuar postin deri në moshën e caktuar kur obligohet pensionimi ose deri në përfundim të kontratës së punës, nëse një e tillë ekziston

13. Gradimi i gjyqtarëve, nëse ekziston një sistem i tillë, duhet të bazohet në fakte objektive, në veçanti në aftësitë, integritetin dhe eksperiencën.

14. Caktimi i lëndëve gjyqtarëve brenda gjykatës të cilës ata i takojnë është një çështje e brendshme e administratës gjyqësore.

### **Sekreti Profesional dhe imuniteti**

15. Gjyqtari duhet t'i përmbahet parimit të sekretit profesional në lidhje me diskutimet e vendimmarrjeve dhe të informatave konfidenciale të marra gjatë kryerjes së detyrës së tyre përveç në seancat që janë publike, dhe nuk duhet të detyrohet që të dëshmojë në raste të tilla.

16. Pa paragjykuar asnjë procedurë disiplinore apo të drejtës për ankesë apo të kompensimit nga shteti, në pajtim me ligjin kombëtar, gjyqtarët duhet të gëzojnë imunitet personal nga paditë civile për dëmet monetare për veprimet e gabuara ose lëshimet gjate ushtrimit te funksioneve gjyqësore

### **Disiplina, pezullimi dhe largimi**

17. Një akuzë apo ankesë e bërë kundër një gjyqtari në kapacitetin gjyqësor apo profesional të tij apo të saj duhet të procedohet shpejt dhe në mënyrë të drejtë me një procedurë adekuate. Gjyqtari duhet të ketë të drejtën për një gjykim të drejtë. Shqyrtimi i lëndës në fazën e saj fillestare duhet të mbetet konfidenciale përderisa nuk kërkohet ndryshe nga gjyqtari

18. Gjyqtarët do të nënshtrohen pezullimit apo largimit vetëm për arsye të paaftësisë apo sjelljes që i bën ata të paaftë për ti kryer detyrat e tyre.

19. Të gjitha procedurat disiplinore, pezullimet apo largimet duhet të përcaktohen ne pajtim me standardet e vendosura nga administrata gjyqësore.

20. Procedurat e vendimeve disiplinore, pezullimi apo largimi duhet të bëhen me ane të një rishqyrtimi të pavarur. Ky parim mund të mos zbatohet në vendimet e gjykatës më të lartë dhe ato të legjislaturës në gjykime apo procedura të ngjashme.